



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE

URDHËR
PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar :

Adresa :

Qendres Kombetare te Regjistrimit


Tirane

Per dijeni: Debitorit- Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D

Adresa: Njesia 2, Rruga "Budi", Sheshi Demokracia, Tirane

Për dijeni: Kreditorit – Shoqeria "Global Logistic" shpk, me Nipt K72113028G

Adresa : Autostrada Tirane-Durres, Km.5



Pranë "Shërbimit Përmbarimor ZIG Shpk" në referim të Vendim Nr. 4859 Akti, date 28.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, është vënë në ekzekutim ky Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 0509-16 Regj, Datë 02.08.2016 kërkesa e kreditorit Shoqeria "Global Logistic" shpk, me Nipt K72113028G, ndaj debitorit Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D, në lidhje me titullin ekzekutiv "Future Tatimore shitje Nr. 8148, date 02.03.2016 me Nr. Serie 207015945.

Pas kalimit në ekzekutim të detyrueshëm si edhe Lajmerim për ekzekutim Vullnetare për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendim Nr. 4859 Akti, date 28.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

Me Shkresën Nr. 18987 Prot, date 16.09.2016 "Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative", është urdheruar vendosja e masës së sekuestros në aktivet e pales debitorë – Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA :

Pala debitorë ka paraqitur prane përmbaruesit gjyqësor mandat pagesën e cila vertetohet shlyerjen teresore të detyrimit sipas titullit ekzekutiv, pagesë e kryer në llogarinë bankare të pales kreditorë Shoqeria "Global Logistic" shpk, me Nipt K72113028G, prane ProCredit Bank.

Në këto kushte, referuar nenit 616/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ :

1. **Heqjen e masës së Sekuestros Konservative**, të vendosur me anë të shkresës Nr. 18987 Prot, date 16.09.2016 në aktivet që zoteron pala debitorë Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D.
2. **Të njoftohemi dhe informohemi** menjëherë në formë shkresore në lidhje me procedurën e heqjes së masës së sekuestros konservative nga ana Juaj.

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në dispozita ligjore, palët mund të paraqesin ankim të vecantë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhri.
- c) Ky urdhër mbahet në 4 (kater) kopje.

"Shërbimi Përmbarimor ZIG Shpk"
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Albert GEGA

